



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

DOKUMENTI I RREGULLORES SË VEÇANTË

"Leje zhvillimi për objektin: "GODINË HOTELERIE DHE BANIMI 1,2,3 DHE 4 - KATE ME 1 KAT PARKIMI NËNTOKË, RR. BIZE, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË DURRËS.



MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

ZNJ. MIRELA KUMBARO



Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 22, Datë 25.09.2024

Projektues:  
DALMAT ARCHITECTURE  
LINDA LOKA (Nr. Lic. A1184/2)



Zhvillues:  
IBA INVEST, SH.P.K.



## TABELA E PËRMBAJTJES DOKUMENTIT TË RREGULLORES SË VEÇANTË

### 1. Dispozita të Përgjithshme

- 1.1 Baza Ligjore
- 1.2 Përshkrim i zonës së studiuar

### 2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor

- 2.1 Përputhshmëria me kategorinë e përdorimit të tokës sipas PPV-së
- 2.2 Seti i fragmenteve të hartave të PPV për zonën në zhvillim

### 3. Analiza e Gjëndjes Ekzistuese

### 4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit

- 4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara
- 4.2 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Rifiniturave
- 4.3 Përcaktimin e treguesve për zhvillim të projekt-propozimit
- 4.4 Hapësirat e lira dhe të gjelbërtë / vendparkimet

### 5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës

- 5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave

## **1. Dispozita të Përgjithshme**

### **1.1 Baza Ligjore**

Kjo rregullore e veçantë përcakton kushtet e përgjithshme të Lejes së Zhvillimit për objektin: “GODINË HOTELERIE DHE BANIMI 1, 2,3 DHE 4 KATE , ME 1 KAT PARKIMI NË TOKË,” në rrugën “Bize”, Durrës, me zhvillues “IBA Invest” shpk.

- Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar nenit 7 dhe neni 28.
- Vendimin Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

### **1.2 Përshkrim i zonës së studiuar**

Zona ku dojenë objektet e propozuara gjendet në fshatin e Lalëzit ne Durrës, në një hapësirë rurale turistike me një distancë nga vija bregdetare 680 m nga deti Adriatik.

Prona ka afërsi me ndërtesa hotelerie dhe resorte të zonës si per shëmbull Hoteli “Movenpick” i cili ndodhet përbullë me pronën tonë, me një distancë prej 300 m, ku ndahet me një rrugë dytësore me dykorsi. “Melia Resor”t eshte një hotel tjetër i zonës i cili ndoshet 1.8 km larg pronës tonë .

Prona ka një aksesim të lehtë nga rruga kryesore e zonës. Gjithashtu ka një pozicion strategjik e cila dallohet lehtesisht nga të gjithë që perdonin rrugën dhe kjo gje mund të çojë që ky projekt të bëhet një landmark i ri i zonës.

Tipologjia e godinave në zonë është e larmishme, duke u nisur nga funksionet, forma e ndërtimit dhe stili arkitektonik. Altimetria e objekteve varion nga 2 kate d, ku përmendim vilat apo ndërtimet pranë bregdetit me funksione shërbimi dhe banimi , deri në 5 kate me funksione të përziera si shërbime, hoteleri, banim. Në zonë pjesa më e madhe e objekteve janë të ndërtuara gjatë periudhës së viteve te fundit te cilat janë zhvilluar dhe si objekte kontemporane duke u kthyer dhe në pikë atraksioni me rëndësi në zonë.

Prona në fjalë është një hapësirë pa ndërtime e rrrethuar nga dy anë nga rrugë kryesore , në njëren anë me një rrugë private dhe ana tjetër me parcele.

Trualli që kërkohet të zhvillohet ka një sipërfaqe totale prej  $13\ 980\ m^2$ , ku përfshihen njëmbedhjetë prona, përkatësisht pronat 445/129, 445/130, 445/131, 445/132, 445/133, 445/134, 445/135, 445/136, 445/137, 445/138 dhe 445/139.



Fig.1 – Pozicionimi i truallit në Google Earth

## 2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor

### 2.1 Seti i fragmenteve të hartave të PPV për zonën në zhvillim

Më poshtë paraqiten të gjitha hartat nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Durrës, në të cilat mendohet se propozimi i projektit “GODINË HOTELERIE DHE BANIMI 1, 2,3 DHE 4 KATE , ME 1 KAT PARKIMI NË TOKË,” në rrugën “Bize”, Durrës, do të jetë funksional dhe në përpunje me kërkesat e zhvillimit të zonës në të ardhmen.



Fig. 5– Harta e Planit të Përgjithshëm Vendor, njësia DR\_UB\_S1\_52/6

### **3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese**

Aktualisht në truall nuk ka ndërtesa ekzistuese.

Ndërtimet në zonë karakterizohen nga tipologji të ndryshme por kryesisht mbizotëron tipologja e shërbimit me funksion hoteleri. Forma e truallit tonë është e rregullt, e sheshtë dhe e pasur pisha mesdhetare bregdetare, rrëth te cilave eshte bazuar dhe koncept ideja e projektit. Gjelberimi ekzistues është menduar te mbrohet .

Pozicioni i pronës është shumë i favorizuar, duke qenë në kryqëzimin e dy rrugëve kryesore të zonës. Vetë pozicioni i jep potencial objekteve që do të zhvillohen në të, të kthehen në “Landmark”, pikë tjeter kyçë për zonën dhe jo vetëm.




Fig. 6 – Foto e gjendjes ekzistuese të truallit

## 4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit

### 4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara

Sipas Planit të Detajuar Vendor të njësisë strukturore DR\_UB\_S1\_52/6, kategoria e përdorimit kryesor është S\_Shërbime.

Konteksti është shume i irregullt dhe i qetë duke qënë qe ska as ndertime të larta dhe as shumë zhurme .Për këtë ideja kryesore konceptuale është projektimi i disa objekteve ne forma organike per te thyer pak kete "qetesë". Frymëzimi për objeket e propozuara ka ardhur nga natyra, një reflektim i projeksionit te pemeve dhe te valeve te detit . Forma e objekteve ka ardhur e tillë dhe nga ruajtja e pozicionimit të pemëve të pishave te larta që ndodhen në shesh, me qellimin qe të mbrohen, duke ruajtur identitetin e nje zone natyrore bregdetare.




Fig. 7 – Skica konceptuale

Masa fillestare influencohet nga kufiri i pronës si edhe parametrat urban që duhen respektuar me godinat përreth. Jane propozuar 2 objekte me funksion hotelerie dhe 3 objekte me të vogla me funksion banimi.

Mënyra sesi janë konceptuar objeket vjen nëpërmjet trajtimit të formës të sfazuar në plan dhe nëpërmjet formes së fasadës, perdonimit të elementeve arkitektonike dhe krijimit të hapësirave bosh-plot në lartësi duke ruajtur një balancë harmonike me tërësinë e objektit.

Hyrja kryesore në objekt bëhet nga rruga e krijuar e vendosur në qëndër të sheshit dhe behet shperndarja në dy anët e sheshit sipas funksionit të godinave , ana e majte per hoteleri dhe ana e djathtë për palazzina në lindje të objektit. Në momentin e hyrjes kemi pranë recepcionin të vendosur në një objekt me vete dhe perkrah saj ndodhen objekte të tjera me funksion sherbimi si dyqane, bar dhe tualete. Hyrja në parkim mundësohet nga dy rampa të ndara në dy anë të sheshit, një qe futet tek hoteli i parë dhe një tek palazzinat ne krahun e djathtë të sheshit. Rrugët kanë formë të çrrugullt të cilat ndjekin formën organike të objekteve .

Hotel i pare ka shtrirje gjatesore dhe në të janë pozicionuar dy grupe shkalle ashensore, ku njera shkon deri në tarracë dhe tjeter shkon deri në katin e dyte duke qënë se objekti krijon një têrheqje në lartesi. Në katin perdhe të hotelit janë pozicionuar dhoma dhe tek pjesa fundore në krah të djathtë është vendosur restoranti i cili aksesohet direkt nga hyrja .Në katet e siperme janë vendosur dhomat. Hoteli i dytë eshte me i vogel në sipërfaqe dhe ka shtrirje gjatesore por në vertikalitet në lidhje me formën e sheshit. Është i së njëjtës tipologji si hoteli i parë dhe ka vetem një grup shkalle ashensor. Kati perdhe është i dedikuar për shërbime , si salle konferencash zyra dhe restorant , ndersa ne katet siper janë pozicionuar dhoma .

Palazzinat janë të pozicionuara në krahun e djathtë të sheshit, dy prej të cilave kanë të njejtën sipërfaqe dhe të njejtën forme por kanë një rrotullim kundrejt njera-tjetres në lidhje me pozicionimin në shesh. Hyrja mundësohet nepërmjet 4 kembe shkalle, ne kuotën +70 cm, dhe nepermjet një koridori të drejtë i cili vjen duke u zgjeruar, shpërndahemi ne secilin apartament. Apartamentet janë shperndarë në tre kate, ku në katin e parë dhe te dytë janë 4 apartamente 1+1 dhe 2 apartamente 2+1. Ndersa ne katin e dytë janë pozicionuar 3 apartamente dhe tarraca e apartamenteve të katit poshtë shfrytezohet si verandë ku mund të pushojnë banoret ose të zhvillohen aktivitete të ndryshme .

E njëjtë tipologji është dhe tek palazzina e trete por ajo ka një shtrirje me te madhe gjatësore , në te cilen ndoshen 10 apartamente për katin perdhe dhe të pare dhe 5 apartamente në katin e dytë. Në të ndodhen dhe dy grupe shkalle ashensore duke qene se ka shtrirje me te madhe dhe numer me të madh apartamentesh .




Fig. 8 – Plani i katit +0\_Hoteli 1




Fig. 9 – Plani i katit +1\_Hoteli 1




Fig. 10 – Plani i katit Odhe +1\_Hoteli 2




Fig. 11 – Plan i katit 0\_Palazzina 1




Fig. 12 – Plani i katit +1\_Palazzina 1

Fig. 13 – Plani i katit +2\_Palazzina 1




Fig. 14 – Plani i katit 0 dhe +1\_Palazzina 3




Fig. 15 – Plani i katit +2\_Palazzina 3

#### 4.2 Pamja e Jashtme e Godinave

Konceptin e projektimit të ndërtesave të frysmezuara nga natyra e sjellim nëpërmjet formave organike të lakuara të fasadës tekete dy hotelet dhe nëpërmjet imitimit të boçes së pishës tek palazzinat, nëpërmjet formës që projektohet si reflektim i tyre në plan dhe në fasadë nëpërmjet elementeve arkitektonike që rrrethojnë cepat e çdo nukli tek apartamentet.

Krijimi i hapësirave midis apartamenteve tek palazzinat, si pasojë e këndit të rrotullimit të tyre kundrejt njera tjetrës, krijon disa hapesira të cilat janë menduar për tu mbushur me gjelberim, duke bërë që objekti të “marrë frysë”, dhe i krijon çdo apartamenti mundsinë e shijimit të natyrës duke qënë me prane natyres . Kjo e fundit shmanget edhe nëpërmjet trajtimit të fasadës me materiale të lehta, transparente.

Krijimi i elementeve arkitektonike tek apartamentet , që rrrethojne cepat e nuklevë , krijojnë më shumë efektin e ngritjes në lartësi te objektit duke qenë se palazzinat janë 3 kate dhe kane shtrirje gjatesore . Këto elemente kanë bazë të rregullt në përmasa por ndjekin formen e nuklevë , e cila sfazohet në lartesi duke u zgjeruar pak dhe duke ngritur kulmin e tyre më lart me 30 cm.




Fig. 16 – Frymězime



Fig. 17 – Render i objektit



Fig. 18 – Render i objektit




Fig. 19 – Render i objektit




Fig. 20 – Render i objektit




Fig. 21 – Render i objektit



Fig. 22 – Render i objektit

#### 4.3 Përcaktimin e treguesve për zhvillim të projekt-propozimit

##### TREGUESIT E ZHVILLIMIT TË PROJEKTIT

1. Sipërfaqe e përgjithshme e truallit:	13 980 m <sup>2</sup>
2. Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura (gjurma):	5 908.96 m <sup>2</sup>
3. Sipërfaqe e truallit e zënë nga pishina:	305.49 m <sup>2</sup>
4. Sipërfaqe e truallit e zënë nga struktura (projeksiuni):	5 453.66 m <sup>2</sup>
5. Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë:	14 372.03 m <sup>2</sup>
6. Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit nën tokë:	11 925.92 m <sup>2</sup>
7. Koeficenti i shfrytëzimit të truallit për ndërtim:	42 %
8. Koeficenti i shfrytëzimit të truallit për rrugë dhe hapsira publike:	58 %
9. Intensiteti i ndërtimit:	1
10. Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit:	22.90 m
11. Numri i kateve mbi tokë:	1-2-3-4 kat
12. Numri i kateve nën tokë:	1 kate

##### TREGUES TEKNIK:

- Zona Kadastrale: Z.K. 1204; Nr. Pasurie 445/129
- Zona Kadastrale: Z.K. 1204; Nr. Pasurie 445/130
- Zona Kadastrale: Z.K. 1204; Nr. Pasurie 445/131
- Zona Kadastrale: Z.K. 1204; Nr. Pasurie 445/132
- Zona Kadastrale: Z.K. 1204; Nr. Pasurie 445/133
- Zona Kadastrale: Z.K. 1204; Nr. Pasurie 445/134
- Zona Kadastrale: Z.K. 1204; Nr. Pasurie 445/135
- Zona Kadastrale: Z.K. 1204; Nr. Pasurie 445/136
- Zona Kadastrale: Z.K. 1204; Nr. Pasurie 445/137
- Zona Kadastrale: Z.K. 1204; Nr. Pasurie 445/138
- Zona Kadastrale: Z.K. 1204; Nr. Pasurie 445/139

#### 4.4 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta / vendparkimet

Në sistemim, pjesa e pandërtuar e truallit është lënë për të ruajtur gjelberimin ekzistues dhe aty ku ska per të krijuar një të ri. Në krahun e djathë të sheshit eshte konceptuar që palazzinat të rrethohen me pasazhe që do i lidhin me njëra-tjetren dhe gjelberimi do përqëndrohet përrreh objekteve. Në krahun e majtë, gjelebrimi është më i përqëndruar në perimetër të sheshit. Dy hotelet do të aksesohen nëpermjet pasazheve nga ana e recepcionit që është objekti që ndodhet në mes, bashkë me objektet e tjera ndihmëse në funksion të hotelerisë.

Në pjesën e mesit të sheshit të ndërtimit kalon një rrugë e cila të çon në parkimin e nëntokës duke aksesuar nëpermjet hotelit të parë-dhe të nxjerr-dhe në anën perëndimore të sheshit, por është menduar që kjo rrugë të mos jetë e hapur gjatë gjithe kohes, por të jetë në levizje të kontrolluar.

Parkimi i objektit është totalisht nëntokë në 1 kat. Parkimii hotelevë aksesohet nga rruga në mes të sheshit, duke u futur nga hoteli i parë. Ndërsa parkimi i palazzinave aksesohet nga rruga ne krahun e djathte . Sipërfaqja totale e ndërtimit nën tokë do të jetë  $11\,920.27\text{ m}^2$

Katet e nëntokës do të ventilohen në mënyrë mekanike dhe hapsirat për flakjen e ajrit do të dalin në disa pika të sistemimit në formën e gojave të ujkut në pjesën Perëndimore dhe ku parkimi del jashtë konturit të katit përdhe.




Fig. 24 – Plani I katit -1

## 5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës

### 5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave

Pozicioni i pronës është i favorizuar nga ana e infrastrukturës, duke qënë se ndodhet shumë afër bregdetit, në një zonë me atraksion turistik. Rruga e vetme që aksesohet zona e gjirit te Lalëzit eshte ngjtur me pronën që do zhvillohet nga ku shtrihet dhe hyrja kryesore për në objekt.

Prona në zhvillim ndodhet 42 km larg Qytetit të Tiranës dhe 30 km larg qytetit të Durrësit në rrugë tokësore .



Fig. 25 - Planvendosje